



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenin 9.1 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-401-11923, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE GRUPIN E LUFTËTARËVE TË UÇK-së PËR PJESMARRJE NË SHËNIMIN E PËRVJETORIT TË BETEJËS SË KOSHARES

Neni 1

Grupi i luftëtarëve të UÇK-së të Komunës së Podujevës, pjesëmarrës në Betejën e Koshares, për shënimin e përvjetorit të Betejës së cekur, mbështeten me mjete financiare, në shumë 700.00 €,

Neni 2

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e z.Enver Sylejmanit, përfaqësues i grupit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400-20896
Podujevë,
15 mars 2016

Kryetari i Komunës
Agim Veliu